REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 154/13
Datë/Datum. 27.07.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 154/13

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues si dhe z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 1019/13 i datës 06. 06. 2019, ku është aprovuar kërkesëpadia e paditësit "Beni Construction & Jaha Company" me seli në Viti, ndërsa është anuluar Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. 154/13, i dt: 26. 06. 2013, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i lokalëve afariste në Qytezën Pejton" me numër të prokurimit NPB 13/013/511, të iniciuar nga AK- Ndërmarrja Publike Banesore (NPB), me datë: 27 korrik 2020, merr këtë vendim:

V E N D I M

I. **Zbatohet**, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti për Çështje Administrative- Prishtinë A. nr. 1019/13 i datës 06. 06. 2019

II. **Mbetët në fuqi**, vendimi AK- Ndërmarrja Publike Banesore, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Ndërtimi i lokalëve afariste në Qytezën Pejton" me numër të prokurimit NPB 13/013/511, duke pasur parasysh faktin se OE i shpërblyer me kontratë, ka nënshkruar kontratën dhe është implementuar projekti.

ARSYETIM

Me datën 29.05. 2013, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 154/13, e parashtruar nga OE NN "Beni Construction & Jaha Company", lidhur me aktivitetin të prokurimit: "Ndërtimi i

lokalëve afariste në Qytezën Pejton" me numër të prokurimit NPB 13/013/511, të iniciuar nga AK-Ndërmarrja Publike Banesore (NPB).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e cekura në raport mendon që autoriteti kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit e lartcekur i ka respektuar procedurat e prokurimit, prandaj rekomandon Panelin Shqyrtues që të aprovohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës ndërsa rekomandon që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesave, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekura në ekspertizë, parashtresave të OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka konstatuar se, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së, si dhe janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE konform nenit 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë "CONEX GROUP", është i përgjegjshëm për faktin se i ka përmbushur: kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 8.1 dhe 8.2 të dosjes së tenderit), dhe kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit), si dhe gjithashtu paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-ja në përgjithësi i ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale të LPP-së duke rekomanduar për dhënie të kontratës OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët konform nenit 60 të LPP-së". Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se në dosjen e tenderit në nenin 8.2 të FDT-së "Dëshmitë e kërkuara dokumentare" pika 2. e dosjes është kërkuar "Kontrata për ndërtime (objekte) të larta në vlerë minimumi 600,00.00€, tri kontrata gjatë viteve 2010,2011,2012, ose dy kontrata për ndërtim të objekteve të ngjashme në vlerë minimumi 400,000.00€, secila prej tyre", ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "CONEX GROUP", ka ofruar disa kontrata siç janë: Kontrata me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, e nënshkruar me 15.09.2009, dhe vlera e kësaj kontrate është 1,459.799.42€, kurse referenca është e lëshuar nga AK-së, me dt: 29.12.2010. Gjithashtu ekziston kontrata së bashku me aneks kontratën me Komunën e Parteshit /Pasjanit, në vlerë prej 975,307.00€, ku realizimi i tyre është bërë në vitet 2011 dhe 2012 dhe referenca është e lëshuar nga AK-së me dt:28.12.2012. Gjithashtu OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "CONEX GROUP", ka kontratë me Komunën e Gracanicës, e nënshkruar me dt: 16.09.2011, dhe vlera e saj është 229,444.55€. Gjithashtu OE

i rekomanduar për dhënie të kontratës ka pas kontratë edhe më herët me AK-së Ndërmarrjen Publike Banesore, dhe vlera e kësaj kontrate është 584,390.94€, prandaj Paneli shqyrtues ka vlerësuar se kjo kërkesë e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës. Gjithashtu në nenin 8.2 të FDT-së piken 3 është kërkuar "Referenca për punë të kryera brenda këtyre viteve së paku në shumën 600,00.00€, e prej tyre së paku dy objekte në vlerë 400,000.00€", ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "KONEX GROUP", ka ofruar një referencë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, e ku vlera e kësaj reference 1,459.799.42€, është më shumë se dyfishi i vlerës së kërkesës në dosjen e tenderit. Kjo e ka bërë të përgjegjshëm OE të rekomanduar sipas panelit shqyrtues.

Ajo çka është cilësuar kontestuese sipas paditësit dhe vetë gjykatës, është çështja e numrit të punëtorëve të paraqitur në ATK. Nga shkresat e lëndës konstatohet se në nenin 9.2 të FDT-së pikën 2. është kërkuar "Numri i punëtorëve të paraqitur në ATK gjatë viteve 2010,2011 dhe 2012, mesatarisht në çdo vit së paku njëherë në vit nga 30 punëtorë", ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës"CONEX GRUP", në TM4-2010 ka të paraqitur 31 punëtorë, gjithashtu në TM4 - 2011 i ka të paraqitur në ATK 33 punëtorë, po ashtu edhe TM2 -2012 i ka të paraqitur 49 punëtorë, çka e ka plotësuar në terësi këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Sipas ligjit për administratën tatimore dhe procedurat ligji nr. 03/L-222, neni 18 paragrafi 2, një tatimpagues mund të dorëzojë një ndryshim deklaratë tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimit. Që i bie se në ndërkohe po që se ka pasur ndonjë ndryshim në deklarim të numrit të punëtorëve ka mundur të rregullohej në ndërkohë. Eksperti shqyrtues ka dyshuar se ka mos përputhshmëri të dhënave përkitazi me numrin e punëtorëve për operatorin ekonomik "Conex Group", dhe ka kërkuar nga ATK që përkitazi me këtë ta bëjë më parë verifikimin në mënyrë zyrtare dhe me një shkresë zyrtare të nënshkruar dhe të vulosur t'i japë përgjigje OSHP-së, ATK ka njoftuar OSHP me shkresë zyrtare se numri i punëtorëve të paraqitur në dosjen e tenderit të operatorit ekonomik "Conex Group" për vitet 2010, 2011 dhe 2012, nuk përputhet me numrin e punëtorëve të paraqitur në dosjen e operatorit në fjalë pranë ATK-së, shkresë kjo zyrtare që ka arritur disa ditë pasi ka vendosur paneli shqyrtues i OSHP-së, përkitazi me ankesën e operatorëve ekonomik në fjalë. Gjithashtu, nga dëshmitari në fjalë është vërtetuar se pas verifikimit të të dhënave nga dosja e ATK-së gjegjësisht arkiva e ATK-së, është vërtetuar se operatori ekonomik "Conex Group", e ka bërë korrigjimin e të dhënave në dosjen e ATK-së dhe atë dy herë radhazi, pasi që më parë janë dorëzuar të dhënat në fjalë, kështu që mos përputhshmëria e të dhënave në fjalë ka ndodhur pikërisht për shkak të korrigjimit të të dhënave nga operatori ekonomik në fjalë, gjë që gjithëherë pra sipas deklaratës së dëshmitarit në fjalë, një gjë e tillë është e lejuar edhe me dispozita ligjore të ATK-së, kur në raste të gabimeve lejohet korrigjimi i të

dhënave dhe atë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjetësh, nga dita e dorëzimit të të dhënave në ATK.

OE ankues ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe -Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative- Aktgjykimi A. nr. 1019/13 i datës 06. 06. 2019, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit OE "Beni Construction & Jaha Company" me seli në Viti, për Anulim vendimi të PSH-së 154/13, i dt. 26. 06. 2013, si dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të atakuar rrjedhë se Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nga vendimi i kontestuar del se, ai përmban të meta të tilla, për shkak të të cilave, nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklarim të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërish arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Sipas gjykatës vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij.

OSHP me tej ka atakuar në Gjykatën e Apelit vendimin e Gjykatës Themelore dhe të njëjtit me datën 29 prill 2010 kanë refuzuar ankesën e OSHP-së duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës themelore.

Gjendja aktuale gjatë Rigjykimit

Paneli shqyrtues pas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ku është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe çështja është kthyer në Rigjykim OSHP ka autorizuar një ekspert shqyrtues i cili përmes raportit të datës 05 qershor 2020, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, ka përgatitur një kronologji.
Pas pranimit të raportit të kronologjisë, shqyrtimit dhe analizimit të Aktgjykimëve të Gjykatës Themelore

dhe asaj të Apelit, paneli shqyrtues konstaton se ky aktivitet të prokurimit ka kohë që është kryer dhe në këtë çështje OSHP ka marrë vendim me numër Psh. nr. 154/13 ku janë shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paditëseve dhe OSHP-ja ka marr vendim, dhe kontrata për këtë aktivitet të prokurimit është realizuar.

Paneli shqyrtues thekson faktin se gjatë kësaj procedurë faktikisht është tërhequr paditësi sepse të autorizuarit e tij nuk kanë marrë pjesë në seancë dhe nuk kanë dhënë fjalën e tyre përfundimtare.

Paneli shqyrtues po ashtu bën të ditur se për këtë aktivitet të prokurimit është zhvilluar edhe një procedurë penale ndaj ekspertit shqyrtues dhe ish Kryetarit të OSHP-së z. Hysni Hoxha të cilët janë liruar nga akuzat si të pafajshëm nga Gjykata e Apelit.

Andaj duke pasur parasysh vërejtjet e gjykatës paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi dhe zbaton Aktgjykimin A. nr. 1019/13 i datës 06. 06. 2019 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 29 prill 2010, me të cilin Aktgjykim është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa është anuluar vendimi i OSHP-së me nr. Psh. nr. 154/13, i dt: 26. 06. 2013, duke u konstatuar se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar, mirëpo paneli vlerëson se pasi që kjo çështje është kthyer në rigjykim pas një kohe të gjatë dhe së tashmë ky aktivitet i prokurimit ka përfunduar, Objektet janë ndërtuar janë lëshuar ne përdorim dhe janë funksionale.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues (paditësi) duhet të ketë parasysh nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092i cili precizon së OSHP me rastin e shqyrtimit të një procedure të prokurimit, kur vendimi i asaj atakohet në gjykatë dhe gjykata vendos në favor të palës, nuk paguan dëmin por këtë e bënë autoriteti kontraktues që ka zhvilluar procedurën:

> *"3. Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëparshme që i është dorëzuar OSHP-së është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga OSHP-ja, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstrojë se ai është dëmtuar nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjykata gjithashtu mund të kërkojë nga*

autoriteti kontraktues që t'ia paguajë parashtruesit të ankesës kompensimin për dëmin e shkaktuar".

Me ligjin për prokurim publik është përgjegjëse përmes paneleve të veta shqyrtuese, të cilat i cakton Kryetari i OSHP-së, për zbatimin e proceduarve për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të LPP-së nr. 04/042, si dhe ka autoritet dhe përgjegjësi ligjore për këtë Pjesë të Ligjit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – NPB

1x1 OE – "Beni Construction& Jaha Company"

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-se